

Paneli II

Z. Gjergj Filipi – moderator

Mirëdita,

Jam i bindur që seanca e parë ishte në pëlqimin e secilit prej jush dhe për mënyrën se si do të funksionojnë instrumentet e shpërndarjes së mirëqenies apo mbrojtjes sociale. Ishte një moment kyç për të bërë një vrojtim të tillë; mbase nuk kemi gjetje të mëdha nga ky anketim, megjithëse unë jam i surprizuar nga niveli i dijenisë. Me këtë vrojtim kemi arritur një gjë shumë të rëndësishme, pasi këtej e tutje do të kemi mundësinë e një baze krahasimi për mënyrën se si politikatat do ndikojnë në përmirësimin e skemave. Pasja e një baze krahasimi, sidomos kolegët që kanë punuar dhe punojnë me statistika apo për kërkuesit shkencorë e kuptojnë shumë mirë, është si pasja e themeleve që do ngrihen në të ardhmen.

Unë gjej momentin të vlerësoj shumë ekipin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i cili pati vizionin, vullnetin dhe durimin që të gjejmë instrumentet si anketa e kryer, e që ajo të realizohet brenda kohës, me burime të kufizuara, efikasitet maksimal, por me një vullnet shumë të madh dhe me një kërkues shumë të madh për të kuptuar se si operon ky dimension i tregut në Shqipëri. Patjetër, falënderoj kolegët e mi të INSTAT-it që pa asnjë shpërblim ekstra, vunë në dispozicion orët e tyre të fundjavës dhe ditët e tyre të pasdites për të gjetur një realitet të shtuar, për të kuptuar një dimension të ri të zhvillimeve socio-ekonomike të vendit. Është fat të punosh me kolegë që kanë gjithmonë kërkuesin dhe vullnetin që t'i dedikohen maksimalisht këtyre lloj zhvillimesh.

Patjetër si çdo produkt, është shumë e rëndësishme që nga mbrapa të kuptojmë se cili është procesi dhe kolegët do të na tregojë diçka më shumë rreth procesit në mënyrë që të dimë dhe cilën nga të dhënat e prezantuara më parë ta shohim me sy më domethënës, apo cilat prej tyre ti çojmë përpara me mekanizma apo instrumente të tjerë, si për shembull me vrojtme që lidhen më shumë me aspekte cilësore sesa sasiore

Ne jemi një vend i vogël dhe mund të inovojmë shpejt, duke pasur mundësi të bëjmë atë kërcimin e madh. Në bashkëpunim me kompanitë celulare kemi gjetur një mënyrë për transmetimin e të dhënave në kohë reale nga vendi ku mblidhen ato. Përpunimi i të dhënave vjen shumë më i saktë, më i shpejtë, por gjithashtu dhe kalibrimi i vendeve ku shkohet vjen gjithashtu më i saktë, më i shpejtë, më i mirë. Në këtë kompleks, patjetër një falënderim shumë i rëndësishëm i shkon kompanive, të cilat e para besojnë tek INSTAT, e dyta mirëpresin shumë anketuesit tanë dhe e treta janë të gatshëm të bëjnë bashkë me ne eksperimente metodologjike, që në fund të ditës janë vlerë e shtuar për statistikat zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Momenti i dytë që desha të nënvizoj nga prezantimet, siç e shpreha dhe më parë, është që ky është një fillim dhe jo një mbarim. Kolegët e AMF-së dinë më shumë se ne në fushën përkatëse dhe mbase do të gjejnë mundësinë në të ardhmen të ndajmë me ju të dhëna shumë më të plota dhe patjetër më të kalibruara, për sa kohë që do të përdoren instrumente më të përshtatshëm.

Ju Faleminderit!